

Njoftim për përqendrim me të cilin e& PPF Telecom Group B.V, Holandë do të fitojë kontrollin mbi SERBIA BROADBAND - SRPSKE KABLOVSKE MREŽE DOO BEOGRAD (VOŽDOVAC), Serbi (lënda nr. 08-42/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 24.02.2025, dhe plotësuar më 07.03.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga e& PPF Telecom Group B.V., me adresë të regjistruar në Zuidplein 168, 1077XV Amsterdam, Holandë mbi SERBIA BROADBAND - SRPSKE KABLOVSKE MREŽE DOO BEOGRAD (VOŽDOVAC), me seli të regjistruar në Bulevardin Peka Dapçeviqa 19, Beograd, Serbi, përfshirë shoqëritë e varura të saj.

Shoqëritë e varura në të cilat SERBIA BROADBAND - SRPSKE KABLOVSKE MREŽE DOO BEOGRAD (VOŽDOVAC) ka ndikim të drejtpërdrejtë mbizotërues:

(i) PREDUZEĆE ZA INFORMATIČKI INŽINJERING I KONSALTING NETLOGIC DOO, BEOGRAD (NOVI BEOGRAD), me seli të regjistruar në Beograd, Omladinskih Brigada 65 B, Beograd Serbi;

(ii) PANTIĆ ELECTRONIC CABLE TELEVISION DOO BEOGRAD-VOŽDOVAC, me seli të regjistruar në Beograd, Bulevardi Peka Dapçeviqa 19, Serbi dhe

(iii) Adria DTH B.V., me seli të regjistruar në Spicalaan 41, 2132 JG Hoofddorp, Holandë, („**Adria DTH**”), përfshirë shoqërinë e varur (ndërmarrjen-bijë) të Adria DTH, TOTAL TV DOO Shkup, me seli të regjistruar në bulevardin Partizanski odredi nr. 17, 1-001, Shkup, Qendër, Maqedonia e Veriut („**Total TV**”).

Menjëherë pas përfundimit të Transaksionit, e& PPF Telecom Group B.V., ka për qëllim të transferojë biznesin e transmetimit satelitor direkt (DTH) („**Biznesi DTH**”) të Telekom Srbija a.d. Beograd, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rrugën Takovska 2, 11000 Beograd, Serbi sipas një marrëveshjeje të veçantë. e& PPF Telecom Group B.V., do të mbajë pronësinë dhe kontrollin mbi biznesin e mbetur, përkatësisht mbi SERBIA BROADBAND - SRPSKE KABLOVSKE MREŽE DOO BEOGRAD (VOŽDOVAC), NetLogic dhe Pantic Electronic, me përjashtim të Biznesit DTH, që në tekstin e mëtejshëm quhet „**Grupi i Synuar**”. Transaksioni për shitjen e mëtejshme do të njoftohet veçmas në Komision nga Telekom Srbija.

e&PPF Telecom Group B.V është një operator telekomunikacioni i madhësisë së mesme (subjekt i mesëm), që operon në tregjet e rajonit të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE). Biznesi kryesor i Parashtruesit përfshin ofrimin e shërbimeve mobile, fikse, të të dhënave dhe televizionit të internetit për përdoruesit përfundimtarë, si dhe shërbime të infrastrukturës së telekomunikacionit për operatorët e telekomunikacionit.

e& është një operator telekomunikacioni me seli dhe bazë në Abu Dabi, Emiratet e Bashkuara Arabe. **e&** ofron zgjidhje inovative digjitale, lidhje inteligjente dhe teknologji të gjeneratës së ardhshme për segmente të ndryshme të përdoruesve.

PPF Group është një grup ndërkombëtar investimesh i themeluar në Republikën Çeke në vitin 1991. Ajo u rrit në një grup që menaxhon operacione në 25 vende në Evropë, Amerikën e

Veriut dhe Azi, ku fushat e saj kryesore të biznesit janë telekomunikacioni, media, shërbimet financiare, e-tregtia, pasuritë e paluajtshme, inxhinieria mekanike dhe bioteknologjia.

As **e&PPF Telecom Group B.V**, as kompania e saj mëmë e& nuk kanë prani operative në Maqedoninë e Veriut (përfshirë degë ose filiale) dhe as nuk kanë ndonjë aktivitet tregtar komercial në Maqedoninë e Veriut.

SERBIA BROADBAND - SRPSKE KABLOVSKE MREŽE DOO BEOGRAD (VOŽDOVAC) ofron shërbime digjitale që mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Serbisë, përkatësisht shërbime të telefonisë fikse, qasje në internet brez gjerë, shërbime të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike. E njëjta nuk ka aktivitet të drejtpërdrejtë në territorin e Maqedonisë së Veriut.

SERBIA BROADBAND - SRPSKE KABLOVSKE MREŽE DOO BEOGRAD (VOŽDOVAC) ka prani indirekte në Maqedoninë e Veriut përmes **Adria DTH** e cila zotëron një pjesë në shoqërinë **TOTAL TV DOO Shkup** e cila është e regjistruar për aktivitete të telekomunikacionit satelitor të regjistruar për kryerjen e aktiviteteve në fushën e komunikimeve satelitore. Total TV operon në tregun e shërbimeve dhe rrjeteve për komunikime elektronike në territorin e Maqedonisë së Veriut, duke ofruar shërbime të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike përmes platformës televizive satelitore Direct-to-Home (DTH).

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën. Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.03.2025

Shkup